

Nr. 139/6 Prot

Korçë më, 02.03.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Sigurimi i automjeteve, sigurimi i shëndetit në udhëtim, sigurimi i aktiveve afatgjata të UKRK Sh.A, si dhe sigurimi nga aksidentet personale"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 66510000-8; 66516100-1; 66720000-3 Shërbime për siguracion; Shërbime për siguracion e detyrueshëm për automjetet; Shërbime për siguracion nga sëmundjet dhe aksidentet.

VLERA E FONDIT LIMIT: 2.011.567 (dymilionenjëmbëdhjetëmijëepesëqindegjashtëdhjetë shtatë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A (UKRK Sh.A), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT


1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ,me vlerë 40.232 (dyzetmijëedyqindetridhjetëedy) lekë (2% të vlerës së përlllogaritur të kontratës).
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9.
- c. Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1.
- d. Formulari Lista e Çmimeve të Shërbimeve, sipas Shtojcës 2.

K. Dishnica



A. Minerali



E. Bicolli



Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2019, 2020, 2021 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 804 626 lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndyshime.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar në dispozitat e sipërpërmendura ku përcaktohet:

Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave **të xhiros vjetore** të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.** Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: **c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, si dhe sipas parashikimit të nenit 55 të Rregullave të PP.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare **konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.**

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet , kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK Sh.A , për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.


Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).


K. Dishnica



A. Minerali



E. Bicolli



Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 402 313 lekë pa TVSH .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të Rregullave të PP ku përcaktohet shprehimisht, citojmë:


" Për kontratat e shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës."

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën si më sipër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (20% x 2.011.567 leke=402 313 leke) . Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A., për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesetim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

A. Minerali



2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencë të vlefshme, të lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, "Për ushtrim veprimtari sigurimi jo jetë", për Sigurim i mjeteve tokësore , Sigurim i përgjegjësive civile nga përdorimi i automjeteve mbi tokë, Sigurim i shëndetit në udhëtim, Sigurim i pasurisë nga zjarri dhe nga forcat e natyrës, si dhe Sigurim i aksidenteve.

(shënim-përcaktimi, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, llojin e licencës së nevojshme që lidhet me objektin e prokurimit, si dhe institucionin që lëshon licencën e kërkuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma "a" të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, si dhe : në Ligjin Nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit"

(shënim- përcaktimi aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale që parashikohet nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoriteti kompetent.

Kriteri dhe kategoritë e saj është në përputhje me natyrën e kontratës dhe në përpjestim me shërbimet e kërkuara të kontratës .


(shënim- nëse është rasti, shtoni argumentimin nga ana teknike për nënlojin/kodin/kategoritë e kërkuara të licencës përkatëse, bazuar në shërbimet objekt kontrate)

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të ketë minimalisht një vlerësues dëmsh, të liçensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr. 9.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

A. Minerali



Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë:

Për vlerësuesin e dëmeve duhet të paraqesë:

Kontratë pune, si dhe

Liçence të vlefshme "Për ushtrim veprimtarie vlerësues dëmsh në sigurime", të lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, apo të specializuar. kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, nenit 41, pika 4/b, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, si dhe :

nenit 227 të Ligjit Nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit";

Rregullores Nr. 85, datë 03.07.2017 "Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime" të ndryshuar,


me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë vlerësuesin e dëmeve të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuarçdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".


A. Minerali




Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sigurimi i automjeteve viti 2023								
Nr	Tipi i automjetit; targa; numri i shashisë, Viti i prodhimit	Kategoria	Vlera e mjetit /për sigurimin kasko	Polica e sigurimit të detyrueshëm TPL		Sigurimi Kasko i plotë		Totali në lekë
				Afati	Vlera në lekë	Afati	Vlera në lekë	
1	AUDI A4 Targa: AA262DL ; Nr i shashisë WUZZZ8K59A172 147; Viti i prodhimit 2008; 280CC	Autoveture B1/2.4	591.991	07.09.2023 deri 05.09.2024		06.04.2023 deri 05.04.2024	x	
2	TOYOTA Targa: AA622ZC ; Nr i shashisë WUZZZ8K59A172 147; Viti i prodhimit 2019; 280CC	Autoveture B1/2.1	1.927.765	24.10.2023 deri 23.10.2024		30.10.2023 deri 29.10.2024	x	
3	TOYOTA RAV4 Targa: AA877EF ; (fuoristradë) Nr i shashisë JTMBB31VX0609 0527; Viti i prodhimit 2008; 220CC	Autoveture B 1/2.2		13.09.2023 deri 12.09.2024				
4	TOYOTA RAV4 Targa: AA405CS ; (fuoristradë) Nr i shashisë	Autoveture B 1/2.2		06.04.2023 deri 05.04.2024				


	JTMBB31V605086 125; Viti i prodhimit 2009; 200CC							
5	TOYOTA RAV4 Targa: AA186EA ; (fuoristradë) Nr i shashisë JTMBB3IV806006 267; Viti i prodhimit 2006; 220CC	Autoveture B 1/2.2			10.06.2023 deri 09.06.2024			
6	TOYOTA RAV4 Targa: AA726IF ; (fuoristradë) Nr i shashisë ; Viti i prodhimit 2014; 200CC	Autoveture B 1/2.1	469.116		11.04.2023 deri 10.04.2024		06.04.2023 deri 05.04.2024	x
7	TOYOTA LAND CRUISE Targa: AB480FP ; (fuoristradë) Nr i shashisë JT111GJ95001470 76; Viti i prodhimit 2000; 280CC	Autoveture B1/2.4			11.04.2023 deri 10.04.2024			
8	NISSAN Targa: KO0029A ; Nr i shashisë JN1WYGY604089 2979; Viti i prodhimit 1996; 300CC	Autoveture B1/2.4			22.10.2023 deri 21.10.2024			
9	FORD Targa KO5094A ; (fuoristradë) Nr i shashisë VSKNXXWGUNR J19515; Viti i prodhimit 1993; 280CC	Autoveture B1/2.4			21.10.2023 deri 20.10.2024			
10	IVECO	D2 Kamion			08.11.2023 deri 07.11.2024			



	Targa AB828GU ; Nr i shashisë ZCFA1EA0002186 795; Viti i prodhimit 1996; Tonaxh; 5 ton							
11	IVECO Targa: KO8753B ; Autobot Nr i shashisë WIMA1VNS40C22 5849; Viti i prodhimit 2008; 330CC	D2 Kamion		08.12.2023 deri 07.12.2024				
12	IVECO Targa: KO6360A ; (Furgon) Nr i shashisë ZCFD40792051096 89; Viti i prodhimit 1996;	D1 Kamionçinë		06.11.2023 deri 05.11.2024				
13	TOYOTA Targa: KO2826B ; (kamionçinë) Nr i shashisë JT133LNG8000226	D1 Kamionçinë		11.07.2023 deri 10.07.2024				
14	TOYOTA Targa: KO2831B ; (kamionçinë) Nr i shashisë JT133LNG8000251 83; Viti i prodhimit 2000; Tonaxh; 0.8ton	D1 Kamionçinë		13.07.2023 deri 12.07.2024				
15	TOYOTA Targa: KO3459B ; (kamionçinë) Nr i shashisë JT133LNG8000256 74; Viti i prodhimit 2000; Tonaxh; 0.8ton	D1 Kamionçinë		23.09.2023 deri 22.09.2024				
16	VOLZWAGEN Targa: AA354EA ; (kamionçinë) Nr i shashisë	D1 Kamionçinë		01.07.2023 deri 30.06.2024				



	WV1ZZZ7IZ9X00 8514; Viti i prodhimit 2008; Tonaxh; 0.8ton							
17	ESKAVATORI Targa: KO3591B ;Nr i shashisë B954PT031051606 ; Viti i prodhimit 2004;	D1 Kamionçinë		13.10.2023 deri 12.10.2024				
18	MERCEDES BENZ Targa: AA885UM ; (Sprinter) Nr i shashisë wdb9066351s4894 24; Viti i prodhimit 2010; Tonaxh;	D1 Kamionçinë		22.07.2023 deri 21.07.2024				
19	MERCEDES BENZ Targa: AA553RH ; (kamionçinë) Nr i shashisë WDB9036611R828 250; Viti i prodhimit 2005; Tonaxh;	D1 Kamionçinë		11.04.2023 deri 10.04.2024				
20	MERCEDES BENZ Targa: AA602US ; (kamionçinë) Nr i shashisë WDB9026221R809 417; Viti i prodhimit 2008; Tonaxh;	D1 Kamionçinë		19.08.2023 deri 18.08.2024				
21	MERCEDES BENZ Targa: AA372TX ; (kamionçinë) Nr i shashisë wdb9036221r47782 7; Viti i prodhimit 2003; Tonaxh	D1 Kamionçinë		10.05.2023 deri 09.05.2024				
22	FORD Targa: AA678TR ;	D1 Kamionçinë		05.05.2023 deri				




(kamionçinë) Nr i shashisë 6FPPXXMJPEB182 01; Viti i prodhimit 2014			04.05.2024				
Totali i sigurimit te automjeteve TPL ; Kasko në lekë							

SIGURIM KARTONA JESHIL				
Nr.	Automjete	Sasia	Çmimi ne leke	Vlera në lekë
1	Sherbim i mundshem, sipas nevojave, per kartona Jeshil 1 vjecar, Veture, Kategoria A.	1 cope		
2	Sherbim i mundshem, sipas nevojave, per kartona Jeshil 2 javore , Veture, Kategoria A.	10 cope		
	Totali në lekë			

SIGURIM SHENDETI NE UDHETIM				
Nr.	Sigurimi i punonjesve	Sasia	Çmimi ne leke	Vlera në lekë
1	Sigurimi i shendetit në udhëtim , ZONA C , 1 person (me afat 1 vit)	1 cope		
2	Sherbim i mundshem, sipas nevojave, per Sigurimin e shendetit ne udhetim 15 ditor, ZONA C	14 cope		
	Totali në lekë			

Sigurimi i aktiveve afatgjata me afat 1 vit				
Nr	Ndërtesa e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN)	Siguracioni	Vlera e siguruar në lekë	Primi i sigurimit në lekë
1	Stacioni i pompimit	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	25 000 000	
2	Godina e operimit dhe garazhi	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	10 000 000	
3	Ajruesat+ pajisje të tjera	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	10 000 000	
	Ndërtesa e Stacionit të Pompave Turan			
1	Rezervuari grumbullues	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	3 000 000	
2	Dhoma e pompave + pompat	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	10 000 000	
3	Dhomat elektrike te pompave + panelet e	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	10 000 000	



	kontrollit			
4	Ndertesa e gjeneratorit + gjenerator	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	8 000 000	
5	Ndërtesa + Dhoma e Komandimit + SCADA sistem	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	20 000 000	
6	Ndertesa	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	10 000 000	
	Ndërtesa e Zyrave të Administratës + ZMK + Rezervuar			
1	Rezervuari nr.1	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	3 000 000	
2	Rezervuari nr.2	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	15 000 000	
3	Rezervuari nr.3	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	15 000 000	
4	ZMK	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	8 000 000	
5	Kompleksi administrativ+ Oficina+ Magazina	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	40 000 000	
	Instalime teknike specifike			
1	Instalime Teknike PUSI 501	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	6 500 000	
2	Instalime Teknike PUSI 502	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	6 500 000	
3	Instalime Teknike PUSI 504	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	6 500 000	
4	Instalime Teknike PUSI 505	Zjarri, Tërmeti dhe Përmytjet	6 500 000	
	Totali në lekë			

SIGURIMI NGA AKSIDENTET PERSONALE			
<i>Sigurimi i punonjësve nga aksidentet personale, me afat 1 vit</i>	<i>Numri i punonjësve</i>	<i>Çmimi (Primi) njësi në lekë</i>	<i>Vlera në lekë</i>
<i>Kërkohet që shuma e sigurimit që do të përfitohet në rast aksidentesh personale, të jetë jo më e vogël se 800.000 lekë , si dhe që shpërblim ditor i paaftësie për ditë kalendarike, të jetë jo më i vogël se 800 lekë.</i>	296		
Totali në lekë			

Pra gjithsej kërkohen:

TPL: 22 copë.

Kasko i plotë: 3 copë.

Karton jeshil, 1 vjeçar: 1 copë.

Sherbim i mundshem, sipas nevojave, per kartona Jeshile, 2 javore: 10 copë.

Sigurimi i shëndetit në udhëtim , ZONA C , 1 person , me afat 1 vit: 1 copë.

Sherbim i mundshem, sipas nevojave, per: Sigurimi i shendetit ne udhetim 15 ditor,ZONA C: 14 copë.

Sigurimi me afat një vjeçar, i aktiveve afatgjata të UKRK Sh.A, sipas të dhënave të tabelës.

Sigurimi me afat një vjeçar, për punonjësit e UKRK Sh. A, nga aksidentet personale, sipas tabelës per 296 punonjës.

Specifikimet teknike

1. Specifikimet teknike per TPL:

Në kuadër të ligjit "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" çdo automjet që qarkullon brenda territorit të Republikës së Shqipërisë duhet të jetë i pajisur me policën TPL (Sigurimi i Detyrueshëm i Mbajtësit të Mjetit Motorik për Përgjegjësinë Civile ndaj Palëve të Treta).

Përmes këtij produkti, shoqëritë e Sigurimeve duhet të mbulojnë përgjegjësinë civile të mbajtësit të mjetit motorik, në përputhje të plotë me parashikimin e Ligjit.

Ky sigurim përfshin mbulimin e shpenzimeve si pasojë e dëmeve materiale, shëndetësore dhe pasurore të shkaktuara ndaj palëve të treta, për shkak të qarkullimit të mjetit motorik të siguruar. Primi për këtë sigurim ndryshon në varësi të specifikave të mjetit motorik.

2. Specifikimet teknike per siguracionet Kasko:


Kërkohet Kasko e plotë. Mbulimi i kaskos të shtrihet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Përmes policës së sigurimit të vetë mjetit motorik KASKO, shoqëritë e Sigurimeve duhet të kryejnë mbulimet në sigurim lidhur me humbjen apo dëmtimin e plotë ose të pjesshëm të mjetit motorik të siguruar si rezultat i rreziqeve të ndryshme.

Përmes këtij sigurimi mbulohen:

- Dëmtimet aksidentale: përplasja e automjetit me një objekt fiks ose të lëvizshëm, përmbysja e mjetit motorik;
- Thyerja e xhamave: thyerja e xhamave të përparmë, të pasmë, anësorë, të tavaneve të hapur, shkaktuar këto nga goditja e një objekti të lëvizshëm;
- Zjarri, rrufeja, eksplozioni: dëmet e shkaktuara nga zjarri, eksplozioni dhe rrufeja;
- Katastrofa natyrore: dëmet e shkaktuara nga stuhia, breshëri, dëborë, tufani, përmblytja, vërshimi dhe dëmet e shkaktuara në mjetin motorik nga rënia e objekteve të ndryshme.
- Vjedhja, tentativë për vjedhje: dëmet që vijnë si pasojë e veprimeve të përvetësimit në mënyrë të fshehtë të mjetit motorik të siguruar, nga një ose disa persona i të gjithë automjetit (vjedhje totale) ose i disa pjesëve të tij (vjedhje e pjesshme). Në këtë rrezik përfshihen gjithashtu edhe dëmet si pasojë e veprimeve që kanë synuar vjedhjen e mjetit motorik por që nuk kanë arritur të kryhen.
- Dëmtime në parkim nga mjete të paidentifikuara.
- Transporti me karotrec.

- Në rast aksidenti të ndodhur në mjete gjatë periudhës të sigurimit, shoqëria e sigurimeve duhet të marrë përsipër riparimin e mjetit deri në kthimin e tij në gjendjen e mëparshme në një nga serviset më të afërta të autorizuar prej saj.



- Dorëzimi dhe marrja e mjetit para dhe pas riparimit pranë servisit të autorizuar të bëhet në prani të përfaqësuesve të palëve.

3. Specifikimet teknike për Kartonin jeshil.

Kërkohej Kartoni jeshil si sigurim i detyruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për sigurimin e palëve të treta.

4. Kërkohej: Sigurimi i shëndetit në udhëtim, ZONA C, 1 person, me afat 1 vit.

5. Është parashikuar:

Fond rezerve për 10 kartona Jeshile 2 javore.

Fond rezerve për: Sigurimin e shëndetit në udhëtim 15 ditë, ZONA C, për gjithsej 14 persona.

Këto Shërbime të **mundshme** do të kryhen sipas nevojës dhe kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

6. UKRK ShA kërkon të bëjë dhe sigurimin e aktiveve afatgjata nisur nga vlera dhe rëndësia e tyre, konkretisht bëhet fjalë për sigurimin e ndërtesës të ITUP, ndërtesës të Stacionit të Pompave Turan, Puseve, ndërtesës të Zyrave të administratës, makineritë dhe pajisjet informatike, si dhe orendi (inventari ekonomik).

Ky sigurim do të bëhet ndaj këtyre risqeve: Zjarrit, Termetit dhe Përmbytjeve, me afat 1 vjeçar.

7. Kërkohej Sigurimi, me afat një vjeçar, nga aksidentet personale, i 296 punonjësve të UKRK ShA. Sigurimi përfshin çdo dëmtim, përfshirë dhe vdekjen nga aksidentet, që ju ndodh punonjësve nga të gjitha llojet e aksidenteve gjatë punës dhe jashtë saj, kudo që ndodhen.

Vlera e përfutur do të jetë në raport me masën e dëmit, të paaftësisë dhe do të përfitohet kundrejt paraqitjes të dokumentave provues.

Kërkohej që shuma e sigurimit që do të përfitohet në rast aksidentesh personale, të jetë një shumë jo më e vogël se 800.000 lekë, si dhe që shpërblim ditor i paaftësie për ditë kalendarike, të jetë jo më i vogël se 800 lekë.

Afatet e ekzekutimit të shërbimeve:

Siguracionet për automjetet, Siguracioni për shëndetin në udhëtim Zona C, Sigurimi i aktiveve afatgjata të UKRK Sh.A, si dhe Sigurimi nga aksidentet personale, i punonjësve të UKRK Sh.A do të behen në momentin (datën) që mbaron afati i sigurimit për vitin 2023 dhe do të zgjatën 1 vit nga kjo datë.

Ndërsa kartonat Jeshile 2 javore, si dhe Sigurimi i shëndetit në udhëtim 15 ditë, ZONA C janë shërbime të mundshme, të cilat do të kryhen sipas nevojës dhe kërkesës së Autoritetit Kontraktor, brenda një viti nga data e lidhjes së kontratës.

Adrian Minerali